VENDIM
Nr. 123, datë 11.5.2021

MBI RISHIKIMIN E VENDIMIT NR. 13, DATË 20.1.2021, PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË ENERGY SUPPLY - AL" SHPK, NR. 115/309, SERIA T11/T15, NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe të nenit 37, pika 2, germa "d", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të nenit 113, të "Kodit të Procedurës Administrative të Republikës së Shqipërisë"; të nenit 4, pika 1, germa "e", të nenit 5, pika 1, germa "e" dhe të nenit 13, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; të nenit 15, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 11.5.2021, pasi shqyrtoi relacionin nr. 68/1 prot., datë 4.5.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, lidhur me plotësimin e kushteve të vendimit nr. 13, datë 20.1.2021, mbi rinovimin e licencës së shoqërisë "Energy Supply - AL" sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- ERE, me vendimin nr. 13, datë 20.1.2021, vendosi:

1. Të rinovojë licencën e shoqërisë "Energy Supply - AL" sh.p.k., me nr. 115/309, seria T11/T15, të shoqërisë "Energy Supply - AL" sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e Bordit nr. 6, datë 2.2.2011, dhe rinovuar me vendimin e Bordit nr. 122, datë 14.10.2015, për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 4.2.2021, me kusht që përpara fillimit të ushtrimit të veprimtarisë së licencuar të depozitojë në ERE:

a. vërtetimet përkatëse të gjykatës dhe prokurorisë për përfaqësuesin me prokurë;

b. dokumentacion vërtetues ku të shprehen qartë vlerat monetare dhe aftësia paguese e shoqërisë mëmë, që ka marrë përsipër të mbështesë shoqërinë "Energy Supply - AL", apo strukturën e financimit.

2. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE, pasi të analizohet dokumentacioni i përcjellë nga shoqëria "Energy Supply - AL" sh.p.k., sipas kërkesave të pikës 1, të këtij vendimi.

- Në vijim të sa më sipër, shoqëria "Energy Supply - AL" sh.p.k., me shkresën nr. 299/6, datë 21.4.2021, përcolli dokumentacionin e munguar.

- Nga analizimi i dokumentacionit të përcjellë në ERE nga shoqëria "Energy Supply - AL" sh.p.k., në kuadër të plotësimit të kushteve të vendimit nr. 13/2021, rezulton si më poshtë:

- Kushti i vendosur në pikën 1, germa "a", "vërtetimet përkatëse të gjykatës dhe prokurorisë për përfaqësuesin me prokurë", të vendimeve nr. 13/2021 dhe nr. 14/2021, është plotësuar nga shoqëria "Energy Supply - AL" sh.p.k.

- Kushti i vendosur në pikën 1, germa "b", "dokumentacion vërtetues ku të shprehen qartë vlerat monetare dhe aftësia paguese e shoqërisë mëmë, që ka marrë përsipër të mbështesë shoqërinë 'Energy Supply - AL', apo strukturën e financimit", të vendimit nr. 13/2021, është plotësuar nga shoqëria "Energy Supply - AL" sh.p.k.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të ndryshojë pikën 1, të vendimit të ERE-s nr. 13, datë 20.1.2021, si vijon:

Të rinovojë licencën e shoqërisë "Energy Supply - AL" sh.p.k., me nr. 115/309, seria T11/T15, të shoqërisë "Energy Supply - AL" sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e Bordit nr. 6, datë 2.2.2011 dhe rinovuar me vendimin e Bordit nr. 122, datë 14.10.2015, për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 4.2.2021.

2. Germat: "a" dhe "b", të pikës 1 dhe pika 2, të vendimit nr. 13/2021, shfuqizohen.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti